

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajsler Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Xheladin Osmani dhe Artan Sejrani, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarëve K.A. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1 të KP-së, dhe R.U. nga Prizreni, për shkak të veprës penale pranimi ose fshehja e sendeve të përfituar me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 të KPK-së , duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PP.nr.278/16 të datës 05.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit K.A. dhe mbrojtësit të tij avokat R. H. nga Prizreni si dhe të akuzuarit R. U. nga Prizreni, më datën 15.05.2017, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I.K.A. , nga i ati P. dhe e ëma M., lindur më “lindur me dt...” në Prizren, me banim në Prizren në rr.”.... ..”nr. .. , fasader, i martuar-babai i dy fëmijeve, ka të kryer shkollen fillor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim prej datës.10.11.206 deri më datën 25.04.2017.

II.R.U. , nga i ati M. dhe e ëma S. , e lindur B. , i lindur më “lindur me dt...” , në Prizren me banim në Prizren në rr.”.... ..” nr. ..., i pa punë, i martuar-babai i katër fëmijeve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

I akuzuari K.A. :

.Se më datën 27.01.2016 rrethë orës 21,40 minuta në Prizren, në rrugën “..... ..” me përdorim të forcës përvetëson pasurinë e luajtshme të dëmtuares L.H., në atë mënyrë që me dhunë e merrë nga krahu çantën e të dëmtuarës L.H., duke i shkaktuar dhimbje në pjesën e sipërme të anës së majtë të qafës me ç’rast ia ka marrë telefonin e tipit „Samsung J5” dhe çantën e hedhë.

Këso dore ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 par.1 të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 7, 17, 45, 46, 73, 83, në lidhje me nenin 329 par.1 të KP e

GJYKON

Me dënimi me gjobë në shumën prej **500/pesëqindë/ Euro** si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3/tre/viteve**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.11.2016 deri më datën 25.04.2017.

Obligohet i akuzuari K.A. që dënimin me gjobë prej 500 ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konformë nenit 46 par.3. të KP, nëse nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën gjykata mund ta zëvendësoi dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtuqë një ditë burgim do të llogaritet me 20 Euro gjobë.

Obligohet i akuzuari K.A. që në emër të paushalit gjyqësor të paguajë shumën prej 200 Euro, në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konformë nenit 364 par.1. pika 1.3. të KPP i akuzuari **R.U. :**

LIROHET NGA AKUZA

Se me datë 30.01.2016 në Prizren në kohë të pacaktuar blen telefonin „Samsung J5” nga i akuzuari i parë K.A. me marrëveshje për një shumë prej 100 franga për të cilën ka mundur të dijë për shkak të çmimit të ultë se është përfituar me kryerjen e veprës penale.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale pranimi ose fshehja e sendeve të përfituar me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 të KP-së.

Konfrom nenit 454 par.1. të KPP shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr278./16 të datës 05.01.2017 kundër të akuzuarëve K.A. për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1. të KP-së, si dhe të akuzuarit R.U. , për shkak të veprës penale pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 të KP-së.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit Mehdi Sefa ka ngelë në tërësi pranë aktakuzës ndaj këtu të akuzuarëve K.A. dhe R.U. për veprat penale si në dispozitivin 1/, dhe 2/, të aktakuzës meqë me provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor me ndëgjimin e të dëmtuares në cilësinë e dëshmitares L.H. si dhe provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pamëdyshje është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit K.A. formohen elementet e veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1.të KP. Kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitares-dëmtuares L. H. por edhe nga telefoni i vjedhur i markes "Samsung" J5 i cili ka qenë i vjedhur natën kritike dhe është gjetur në posedim të akuzuarit K.A. .

Këtë telefon i akuzuari i parë K.A. ia ka shitur për 100 franga të akuzuarit të dytë R.U., i cili në bazë të çmimit është dashur të dijë se është përvetësuar me veper penale, gjë që edhe në veprimet e të akuzuarit të dytë formohen elementet e veprës penale pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1. të KP-së. Andaj, ka propozuar që gjykata ti shpall fajtor dhe ti dënoi sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.A. av.R.H. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka dorëzuar në formën e shkruar dhe se gjatë elaborimit ka deklaruar se K.A. nuk është kryerës i veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1. të KP, ndaj të dëmturës L. H. nga fakti se kjo vërtetohet nga deklaratat e të akuzuarit R.U. edhe në shqyrtimin kryesor të datës 25.04.2017 i cili ka deklaruar se poasi është këthyer nga policia ku e kishte dorëzuar telefonin e blerë nga K.A. ka shkuar në shtëpinë e K.A. dhe pas kësaj K.A. i ka thënë që të shkojnë së bashku në polici, i akuzuari K.A. iu ka paraqitur në telefon një polici të cilin R.U. e ka kojshi dhe që i ka thënë që ditën e nesërme do të paraqitet vet në polici, i njejtë është paraqitur dhe atë ditë është ndaluar. Poashtu edhe çështja e identifikimit të akuzuarit nga e dëmtuara L.H. është provë e papranueshme pasi është siguruar në mënyrë të kundërligjshme në kundërshtim me neni 120 par.1. dhe të KP.E dëmtuara me rastin e identifikimit ka qenë e udhëzuar, ka vepruar me sugjestion sepse ajo para vehtes ka patur vetëm një person – K.A.. Andaj, duke u nisur nga këto fakte propozon që ndaj të akuzuarit të merret aktgjykim lirues. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari K.A. .

I akuzuari R.U. ka theksuar se e ndjen veten të pafajshëm dhe i ka propozuar trupit gjykues që të merr aktgjykim lirues.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje gjykata gjatë procedurës së provave ka ndëgjuar në cilësi të dëshmitares të dëmtuarën L.H. e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 25.04.2017 ka theksuar se ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori dhe se natën kritike ishte duke u kthyer nga qyteti dhe posa ka arritur

afër Qendrës sportive, ku edhe banon, diku rrethë orës 21,40 minuta, K.A. ishte duke hypur shkallëve, e ka kap për dore – në dorën e djathtë për krahu, në krahun e majtë e ka patur çantën dhe duke e ngreh çantën nga forca e të akuzuarit është rrëxuar në tokë. Telefoni ka qenë në xhepin e çantës, patenti ka qenë i hapur ashtuqë i akuzuari e ka marrë telefonin. Në momentin kur personi e ka kryer këtë vepër e ka verifiku vetëm pjesën kah ana e syrit, nuk e ka ditur që është K.A dhe se në bazë të përshkrimit të saj të cilin e ka bërë në polici kur e ka paraqitur rastin, policia kur e ka gjetur telefonin është vërtetuar që ai ka qenë K.A. . K.A. e njuh sepse nëna e K.A. dhe kunata e tezës “janë diçka”, poashtu edhe ka qenë në mahallën ku jeton K.A. e poashtu edhe në shkollën “... ..”, bashkë kanë qenë në atë shkollë. Vendi ku ka ndodhur grabitja ka qenë e ndrikuar nga dritat e Qendrës sportive. Identifikimin në polici kur e ka bërë ka qenë vetëm K.A.. Si e dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike pasiqë telefoni i është kthyer.

Nga provat materiale – vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve të datës 09.11.2016 vërtetohet se është sekuestruar një telefon mobil i markës “Samsung” J5 nga R.U. me nr.serik të IMEI-t / .. dhe se telefoni i njëjtë i është kthyer të dëmtuarës L.H. ,gjë që është vërtetuar nga vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara.

Nga raporti i policisë në lidhje me kalimin kufitar vërtetohet se personi E. Xh. prej datës 12.02.2015 ka dalë prej pikës kufitare në Vermicë – nga Kosova dhe se nuk ka të dhëna tjera pas kësaj date se personi i njëjtë ka hyrë përsëri në Kosovë.

I akuzuri K.A. në mbrojtjen e vet ka ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori në procesverbalin e datës 18.11.2016 duke cekur se telefonin “Samsung Galaxi” J 5 A, ia ka shitur për 100 Franga këtu të akuzuarit R.U. të cilin telefon e ka blerë prej E.Xh. dhe ate 2-3 ditë para se të ia shet të akuzuarit të dytë. Për këtë telefon të akuzuarit ia ka dhënë një automjet “...” të vjetër kurse prej tij ka marrë 80 Euro dhe një telefon të markës Samsung. Sa i përket të dëmtuarës L.H. të njëjtën nuk e njuh.

I akuzuari R.U. në mbrojtjen e vet gjatë shqyrtimit gjyqësor poashtu ka ngelë pranë deklaratës së dhënë në prokurori në procesverbalin e datës 04.01.2017 duke cekur se K.A. e njuh dhe se nga ai ka blerë telefonin e markës “Samsung” për shumën prej 100 Franga Zvicrane. Kurrë nuk ka menduar se telefoni mund të jetë i vjedhur pasiqë nuk merr vesh nga telefonat, kur e ka blerë telefonin, e ka pyet djalin se a po i pëlqen telefoni dhe se telefonin e blerë ia ka dhënë djalit.

Në bazë të provave të lartëcekura, pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhëshmëri me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se më datën 27.01.2016 rrethë orës 21,40 minuta në Prizren, në rrugën “..... ..” me përdorim të forces përvetëson pasurin e luajtshme të dëmtuares L.H., në atë mënyrë që me dhunë e merrë nga krahu çantën e të dëmtuarës L.H., duke i shkaktuar dhimbje në pjesën e sipërme të anës së majtë të qafës me ç’rast ia ka marrë telefonin e tipit „Samsung J5” dhe çantën e hedhë.

Gjendjen e këtitillë faktike gjykata e vërtetoi në bazë të deklaratës së të dëmtuarës L.H. e cila deklaroi se telefoni i është vjedhur natën kritike më datën 27.01.2016 në afërsi të Qendrës sportive në Prizren dhe se telefonin ia ka grabitur K.A. pasiqë të njejtin e ka njohur edhe më herët nga shkolla, të dy kanë shkuar në shkollën e njejtë – “... ..” dhe kanë jetuar në një mahallë.

Poashtu kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga provat materiale – vërtetimi mbi sendin e sekuestruar pasiqë telefoni është gjetur tek i akuzuari i dytë R.U. .

Mbrojtjes së të akuzuarit K.A. se telefonin e ka blerë nga E.Xh. gjykata nuk ia fali besimin dhe se mbrojtja e këtitillë e të akuzuarit është në kundërshtim me provat materiale – raportin e Policisë së Kosovës mbi kalimin kufitar nga i cili raport edhe është vërtetuar se personi me emrin E.Xh. nuk ka hyrë në Kosovë prej datës 12.02.2015. Andaj, mbrojtja e këtitillë e të akuzuarit për gjykatën është vetëm përpjekje për shmangje nga përgjegjësia penale, nga fakti se telefoni i të dëmtuarës është gjetur tek i akuzuari i dytë R.U. ,i cili këtë e ka blerë nga i akuzuari K.A. ,fakt të cilin nuk e mohon as vet K.A. .

Është fakt se identifikimi në polici nuk është bërë konformë dispozitave të nenit 120 të KPP pasi që me rastin e identifikimit të dëmtuarës i është prezentuar vetëm këtu i akuzuari, mirëpo, në bazë të përshkrimit të mëparshëm të cilin e ka dhënë e dëmtuara policisë pas grabitjes së kryer, policia edhe ka arritur që ta identifikoi personin i cili e ka kryer veprën penale dhe e ka gjetur telefonin e grabitur tek i akuzuari i dytë R.U., i cili telefon i përket të dëmtuarës L.H. . Andaj, në bazë të këtyre fakteve gjykata edhe ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit K.A. formohen elementet qenësore të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.l. të KP, pasiqë i njejtin me përdorim të forcës – duke e kapur për dore të dëmtuarën dhe duke e rrëxuar për toke e pëvetëson pasurinë e luajtshme – telefonin e të dëmtuarës, me qëllim që vedit ti sjellë dobi të kundërligjeshme pasurore.

Andaj, edhe gjykata bazuar në të lartëcekurat gjeti se këtu i akuzuari K.A. është përgjegjës për veprën e lartëcekur penale, për çka edhe të njejtin e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me gjobë dhe me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket të akuzuarit R.U. dhe veprës penale e cila i vëhet në barrë me aktakuzë – blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.l. të KP, kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë që nënkupton dijeninë e të akuzuarit se sendi është vënë në dorë me vepër penale.

Në rastin konkret prokuroria nuk ka mundur që të vërtetoi me asnjë provë se këtu i akuzuari i dytë R.U. e ka kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë respektivisht se i njejtin ka patur dijeninë që telefonin që e ka blerë është përfituar me vepër penale.

Andaj, në mungesë të provave të cilat do të vërtetonin fajsinë e të akuzuarit të dytë R.U. gjykata e liroi nga akuza, pasiqë nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është i akuzuar.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 73 të KP, sa i përket të akuzuarit të parë K.A. përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njejtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjesisë, motivet nga të cilat është kryer vepra penale dhe se prej rrethanave lehtësuese morri parasysh qëndrimin korrekt të tij gjatë tërë procedurës penale, se është i martuar – i ati i dy fëmijëve dhe i gjendjes së dobët ekonomike. Ndërsa prej rrethanave rënduese faktin se i njejtë është recidivist dhe se është gjykuar me aktgjykimin e plotëfuqishëm të kësaj gjykate P.nr.39/08 të datës 08.07.2015 për veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.I.lidhur me nenin 23 të KPK dhe është gjykuar me dënim me kusht. Andaj, është mendimi i gjykatës që dënimin i shqiptuar do ta arrij qëllimin e vet konformë nenit 41 të KPK, se dënimin i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësojë një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Gjukata është e mendimit se dënimin i shqiptuar të akuzuarit është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjesisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP në të gjitha segmentet e tij. Dënimet e shqiptuara për kah lloji dhe lartësia janë në harmoni me rrethanat e rastit, të nevojshme dhe të mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartëcekur. Dënimin i shqiptuar të akuzuarit sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të mirret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, dënimet e këtilla paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro-juridike është marrë konformë nenit 463 par.2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.I. të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti për krime të rënda

Më dt.15.05.2017. P.nr.1/17

**Proçesmbajtësja
Sheqere Braha**

**Kyetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi**

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.